



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ZYRA E PËRMBARIMIT "BEST 2010"

Nr.160/8 prot.

Datë. 24 janar 2019

**URDHËR**

**Lënda:** Sekuestro për asetet e debitorit

**Drejtuar:** Qendrës Kombëtare të Biznesit

I nderuar drejtor,



Unë Saimir Hoxha, Përmbaruesi Gjyqësor, pasi studiova dokumentacionin që i përket Urdhrit të Ekzekutimit nr. 644, datë 09.10.2018 të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës,

**KONSTATOVA:**

Se pranë kësaj zyre përbarimi është depozituar kërkesa e kreditorit për zbatimin e titullit ekzekutiv (fatura tatimore nr. 173, datë 10.08.2015) me palë e objekt:

-**Kreditor:** Shoqëria "Alushi-Trans" Sh.p.k

-**Debitor:** Shoqëria "Novo Sapac Energie" Sh.p.k (Nuis: L32402010B, Adm. Besim Mulaj)

-**Objekti:** Detyrim monetar

Nga shqyrtimi i dokumentacionit del se debitori duhet të përmbushë detyrimin ndaj kreditorit si dhe shlyerjen e tarifave/shpenzimeve përbarimore/gjyqësore.

Debitori duhet të shlyejë detyrimin e përcaktuar në urdhrin ekzekutiv.

Ende sot e kësaj dite debitori (administratori, etj) nuk e ka shlyer këtë detyrim e për rrjedhojë QKB mund të nxjerrë një njoftim/shpallje ku të evidentohet ky detyrim.

Për sa më sipër bazuar në nenet 519 e në vijim të K.Pr.C e në nenin 46 i ligjit nr.10031, dt.11.12.08 "Për shërbimin përbarimor gjyqësor" i ndryshuar,

**JU KËRKOJ QË:**

1- Të mbani nën sekuestro asetet që i takojnë debitorit në çdo lloj aktiviteti për të cilin ju keni informacion;

2- Të informoni me shpallje ose me punonjësit tuaj, debitorin për këtë detyrim;

3- Të më informoni për veprimet tuaja rreth kësaj kërkesë brenda afateve ligjore.

- Bashkëlidhur ju lutem gjeni një kopje të urdhrin ekzekutiv.

Faleminderit për bashkëpunimin/mirëkuptimin

**PËRMBARUESI GJYQËSOR**

**SAIMIR T. HOXHA**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Nr. Regjistri Them (90109- 02744) 644      Data e Rregjistrimit 21.9.2018

Nr. Vendimi (11-2018-4947)644      Data e vendimit 9.10.2018

**URDHËR EKZEKUTIMI**  
**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e përbërë prej;**  
**GJYQTARE : Mimoza Margjeka**



Në Durrës, sot më datë 9.10.2018, shqyrtoi në Dhomën e Këshillimit çeshtjen, që i përket :

**KËRKUES:** "Alushi - Trans" shpk, me seli autostrada Tirane - Durrës

**OBJEKTI:** Lëshimi i Urdhrit Ekzekutiv për faturën tatimore me nr. serie 18513423 dt 10/08/2015.

**Baza ligjore:** Nenet 5 e 16 të Ligjit 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare"; nenet 510 (paragrafi e) e 511 (paragrafi d) të K.Pr.Civile.

**V Ë R E N**

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është paraqitur kërkesa me kërkuar, Shoqëria "Alushi - Trans" shpk me objekt të sipërcituar.

Kerkuesi referuar objektit të aktivitetit të tij tregtar, është lidhur me mardhënje tregtare me subjekti Shoqëria "NOVO SAPAC ENERGIE" SHPK sipas faturave tatimore respektive të shitjes me nr. serie 18513423 dt 10/08/2015.

Në shkelje të detyrimeve që lindin nga shërbimet e kryera, blerësi nuk ka përmbushur detyrimin monetar që rrjedh nga faturat tatimore të shitjes, të sipërcituara.

Kërkuar ka ofruar shërbimin subjektit Shoqëria "NOVO SAPAC ENERGIE" SHPK i cili e ka pranuar këtë detyrim dhe nuk e ka përmbushur atë brenda afatit ligjor.

Ne rastin konkret, bazuar ne nenin 36 të K.Pr.C çeshtja i përket juridiksionit gjyqësor, Gjykata e Shkalles së Parë Durrës ka kompetencë lëndore (neni 41 KPC) dhe kompetencë tokësore bazuar ne nenin 511/ç KPC ne korelacion me nenin 448 paragrafi 1 dhe 461 të KC, kjo gjykate është kompetente.

Ne baze të faturave tatimore TVSH lëshuar nga kerkuesi, vërtetohet kryerja e shërbimit prej tij. Kjo faturë edhe pse e njohur nga pala debitorë, nuk është likuiduar vullnetarisht nga ana e tij. Fatura është e rregullt dhe e deklaruar ne organin tatimor prej kerkuesit.

Bazuar ne nenin 16 të ligjit 48/2014, detyrimet monetare të lindura nga veprimet juridike tregtare përbejnë titull ekzekutiv. Ne vetvete, titull ekzekutiv përbehet nga :

1. detyrimi principal i pasqyruar ne fature (neni 16) ;
2. kamatëvonesa ligjore mbi shumën (neni 5) ;
3. shperblimi për shpenzimet për avokat(neni 11)



4. demshperblimi prej 5000 leke, i paracaktuar me ligj (neni 12)

Sa me sipër, në kushtet kur detyrimi nuk është likuiduar vullnetarisht nga debitori, duhet të lëshohet urdhëri i ekzekutimit me qëllim vijim të procedurave përbarimore të ekzekutimit.

Po kështu në kuptim të nenit 510 shkronja "e" të K. Pr. Civile "Janë tituj ekzekutivë: aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet Zyra e Përbarimit për ekzekutimin e tyre":

Pasi u njoh me provat dhe bazën ligjore të kërimit gjykata çmon se kërkesa është e bazuar dhe duhet të lëshohet urdhëri i ekzekutimit për Faturat Tatimore të Shitjes objekt kërrimi.

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të neneve 510 e vijues të K. Pr. Civile si dhe neneve 5, 11, 12 dhe 16 të ligjit Nr. 48/2014, datë 20.05.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare"

### **V E N D O S I**

Pranimin e kërkesës

Lëshimi i Urdhrit të Ekzekutimit për Titujt Ekzekutiv, Faturë Tatimore e shitjes numër me nr. serie 18513423 dt 10/08/2015.

Urdhërohet shërbimi përbarimor gjyqësor, shtetëror ose privat për ekzekutimin e këtij vendimi.

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuarit.

Ky vendim lëshohet vetëm në një kopje.

**Durrës më datë 9.10.2018**

Shpenzimet gjyqësore	
Taksa gjyqësore	200 lekë
<b>Totali</b>	<b>200 lekë</b>

**GJYQTARE**  
**MIMOZA MARGJEKA**

